



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 3150 / 5 prot.

Pogradec, më 21, 08, 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

" MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (TREQIND E TREMIJE E DYQIND E PESEDHJETE E NENTEMIJE) M2."

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 16(Gjashtembedhjete)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____ / ____ /2025

PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjetë e nentemije) M2.

1. Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave, Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytëzim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

2. Të miratojë në parim dhënien me qira, per ndertim fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.), për pasuritë e ndodhur në fshatin Çërravë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

N r	Pron esia	Zona Kadastrale	Nr Pasurise	Vendodhja	Lloji	Siperfaqja ne m2
1	Shtet	1387	30/2	Çërrave	Kullote	214759
2	Shtet	1387	32	Çërrave	Kullote	50500
3	Shtet	1387	35	Çërrave	Kullotë	5000
4	Shtet	1387	66	Çërrave	Kullotë	33000
					TOTALI	303259

- 
3. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje, sipas periudhes te percaktuar ne projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit në konkurim.
 4. Ne referim te bazez ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimit nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të percaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "
 5. Tarifat për dhënien me qera të kesaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "8", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
 6. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
 7. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCËVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TOKES BUJQESORE NE NJESITE ADMINISTRATIVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

Nr. 3150 / 5 Prot.

Pogradec, më 21.08.2025

RELACION
PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (TREQIND E TREMIJE E DYQIND E PESEDHJETE E NENTEMIJE) M2.

I NDERUAR KRYETARE KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, referuar pikës 2 të nenit 27 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ndër të cilat është edhe Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme, pyll,etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posacerisht të kaluara në pronësi të saj me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave /Bashkive", Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin.

Për sa më sipër, Sektori i Trajtimit të Titujve të Pronësisë dhe Shpronësimeve, Bashkia Pogradec, ka marrë evidentuar pronen me nr 30/2, 32, 35 dhe 66 Zk 1387 qe mund të jete prone qe mund të zhvillohet nga individe të ndryshëm për qellimin e cituar më lart, për vetë pozicionimin dhe vendosjen e kesaj prone mabsi është larg nga qendrat e banuar dhe pa ndikime në mjedis.

Nga analiza dhe interesimi i disa individeve dhe pozicionin e pasurisë propozojmë dhenien me qera të sipërfaqes prej 30,3259 ha sipërfaqe e cila sipas llojit të qeverisjes së pyjeve sipas planit të mbareshtrimit të ish komunes Cerrave është kullote në vendin e quajtur Çërravë si dhe nga verifikimi në vend dolen me këto konkluzione:

Sipas VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave /Bashkive", pasuria 30/2, 32, 35 dhe 66 Zk 1387, që është pjesë e ngastrave kullosore të Ekonomisë Kullosore Pretushe -Lin kalon në pronësi Bashkise Pogradec, e cila duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore është paisur me dokumentacionin përkatës të pronësisë, bashkangjitur këtij relacioni.

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Per sa me siper, u monitorua pasuritë 30/2, 32, 35 dhe 66 Zk 1387 kullote qe kerkohet te miratohet ne parim fillimi i procedurave per dhenie me qira, me siperfaqe 303259 m2, me të dhënat si më poshtëme;

N r	Pronesia	Zona Kadastrale	Nr Pasurise	Vendodhja	Lloji	Siperfaqja ne m2
1	Shtet	1387	30/2	Çërrave	Kullote	214759
2	Shtet	1387	32	Çërrave	Kullote	50500
3	Shtet	1387	35	Çërrave	Kullotë	5000
4	Shtet	1387	66	Çërrave	Kullotë	33000
					TOTALI	303259

Siperfaqia e kerkuar ndodhet , ne kufirin ndermjet Fshatrave Çërravë dhe Lumas ne nje largesi te konsiderueshme nga qendrat e banuara, dhe tradicionalisht ka qene pjese e fshatit Çërravë.

Ne referim te bazez ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "

Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "8", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

Perfundimisht, per sa me siper, Në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12 2014 "Për veteqeverisjen vendore", citohet se: **"Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve", ju informojme se ne date 18.08.2025 është realizuar edhe konsultimi publik me banoret dhe anetare te keshillit Bashkiak.**

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.

Ju Faleminderit !

Ju faleminderit!

Konceptoi: Nexhmi TORRA

Konfirmoi Paskalino ZIKO

Miratoi Dritan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 18/08/2025 **Ora :** 10 :00

Vendi: Fshati Cërravë

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 28 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktet që konsultohen :

**PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 35,5200 HA,
E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË
JEPEN ME QIRA.**

**PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE
INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET,
BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME
SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjetë e
nentemije) M2.**

Pjesëmarrës :

Ahmed Guxholli	(Këshilltar)
Odhise Mihallari	(Këshilltar)
Vjollca Pllaha	(Këshilltare)
Nexhmi Torra	(Specialist I Bashkisë)
Jona Bojko	(Sekretare e Këshillit)

Olger Ibi (Administrator I njësisë Cërravë) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

-Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.

- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.



Jona Bojko (Sekretare e Këshillit): Në mbledhjen e muajit Korrik të Këshillit Bashkiak u përcollën dokumentat e dy projekt-vendimeve .

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 35,5200 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjetë e nentemije) M2.

Këshilli vendosi që këto projekt-vendime të kalojnë në konsultim publik dhe ne kemi ardh sot për të dëgjuar mendimin tuaj në lidhje me dhënien me qera të këtyre sipërfaqeve për ndërtim fotovoltaike. **N. Torra:** Mbas verifikimeve që kemi bërë në drejtorinë e Ashk dhe duke u nisur nga kërkesat që kani bërë subjekte të ndryshme për zhvillime të reja që kanë marrë kryesisht në shfrytëzimin e energjisë së gjelbër, kemi një kërkesë për zhvillimin e kësaj zonës. Ne i kemi ndarë në dy kategori. Një pjesë janë toka pyjore dhe pjesa tjetër që është krah perballë. Parimisht dhe teknikisht në momentin kur te bëhet kontrata do vecohen dhe hapësirat të cilat kanë pronar. Procedurat do jenë të hapura dhe secili që ka interes mund të aplikojë.

Rafet Kapo: Ne duam ti marrim si fshat. E marim me qera dhe paguajme qeranë dhe taksat që duhet

Genci Beshello: Ne jemi interesuat para disa vitesh për ti marrë me qera dhe nuk na janë aprovuar. Vendoseni veten tuaj në vendin tonë. Ne këto toka kemi për përdorim, nqs na i marrim dhe këto skemi vefarë të bëjmë. Përcillen mendimin tonë. Gjithashtu para disa kohësh kur kemi bërë takim na është premtuar që do na jepet mbështetje për kullotat dhe spo shohim asgjë.

Anis Dervishi; Ne me kullotat ushqejmë familjet tona. Kullotat jsnë e ardhura e vetme që kanë shumë familje. Ne nuk po kërkojmë asgjë vetëm të na lini këto tokat që kemi në mënyrë që të vazhdojmë të mbajmë familjen.

N.Torra: Kullotat do jenë gjithsesi.

G. Beshello; Ne nuk bijem dakort sepse janë tokat që ne duam të kullosim bagëtitë.

Lulëzim Kapa; Në një takim na kanë thënë që kullotat nuk do të zihen. Ne jemi dakort që këto toka t mbajë Bashkia dhe ne ti marrim me qera për të kullotur bagëtitë. Ne jemi të gjithë të gatshëm të paguajmë taksa.

Andrea Beshello: Nqs ne na sigurojnë që do punësohet një pjesë e mirë e banorëve të fshatit atëherë n bijem dakort.

Lulëzim Kapa: Gjithashtu kemi një shqetësim tek rezervuari i Grabovicës, banorët nuk janë dakort të mbahet peshk sepse i pengon për të ujitur.

Genci Beshello: Perfundimi është që ne nuk jemi dakort që keto toka të jepen me qera, nqs duhet i marrim vete jemi të gatshëm.

Sekretare e Këshillit

Jona BOJKO



Muk jemi do hort te gjitha.



Darko Jupa DS

Selmond Bebellu DS

Zaimin Kapa DS

Ljuro Kapa DS

Altin Kapa DS

Rivijon Kapa DS

Gozmor Bebellu GB

Genç Berberi GP

Artan Bebellu GP

Envis Kapa GP

ANIS Dervishi AD

Jalorim Kapa DS

Ledio Haxho DS

Andrea Bebellu DS

Andit Kapa DS

FREDI KAPA DS

ANKHI KAPA DS

Moteg Kapa DS

PERPARIM Kapa DS

Endri Kapa DS

ALTIN Bebellu DS